

VENDIM
Nr.561, datë 28.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.483, DATË 29.7.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT, KU ËSHTË NDËRTUAR
FSHATI I FËMIJËVE, NË TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9967, datë 27.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.483, datë 29.7.1996 të Këshillit të Ministrave, afati “për 20 vjet” të bëhet “për 49 vjet”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha